



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SHKUMBIN

VENDIM

Nr.10, datë 27.12.2019

PËR

**MIRATIMIN E KORIGJIMIT TË VENDIMIT NR.69/1 DATË 29.10.18 "TË
MIRATIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT NR.82/1 DATE 05.11.18 TË
SHFYTEZIMIT TË BURIMIT UJOR PËR PRODHIM HIDROENERGJIE
BASHKIA POGRADEÇ ,QARKU KORÇË TË SUBJEKTIT HEC LLËNGË**

Në mbështetje të nenit 50, pika 5/c, të Ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM 221 datë 26.04.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencise se Menaxhimit të Burimeve Ujore ", dhe Vendimit të Këshillit Kombetar të Ujit Nr 6 datë 12.06.2019 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" si dhe në zbatim të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Proçedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 112 me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.
Keshilli i Basenit Ujëmbledhes Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e korigjimit të Vendimit Nr. 69/1 datë 29.10.18 të subjektit "Hec Llëngë" sh.p.k me objekt "Leje për shfrytëzim për prodhim hidroenergjie", nga fuqia e instaluar **2080 kw** të bëhet **1730 kw** si dhe vepra e marrjes Nr.2 në kuotën **Z = 1112 mnd** të bëhet **Z = 1110 mnd**.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MAKSIM MALAJ

